



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

**Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023**

*Prishtinë, 2018*

## 1. PËRMBAJTJA

1.	PËRMBAJTJA .....	2
2.	LISTA E SHKURTESAVE.....	3
3.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....	4
4.	HYRJA.....	5
5.	METODOLOGJIA.....	6
6.	ANALIZA E GJENDJES AKTUALE DHE SFIDAT KRYESORE.....	7
6.1	Nevoja për një sistem të qëndrueshëm që siguron zhvillim ekonomik lokal .....	7
6.2	Sfidat kryesore të komunave që duhet të adresohen.....	9
6.3	Politikat strategjike për zhvillim ekonomik lokal.....	14
6.4	Investimet në nivel lokal.....	17
6.5	Burimet e financimit të komunave.....	17
6.6	SWOT ANALIZA .....	21
7.	VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE .....	23
7.1	Vizioni .....	23
7.2	Objektivat strategjike.....	25
7.3	Praktikat e vendeve të rajonit.....	29
8.	INTERVENIMET KRYESORE TË STRATEGJISË.....	34
9.	MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË .....	34
9.1	Monitorimi dhe raportimi i Strategjisë .....	34
10.	NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË .....	35
10.1	Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve.....	35
10.2	Burimet e financimit të Strategjisë.....	35
11.	SHTOJCA 1: Plani për Zbatimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal .....	36

## 2. LISTA E SHKURTESAVE

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
ZKM-ZPS	Zyra e Kryeministrit - Zyra për Planifikim Strategjik;
MIE	Ministria e Integrimit Evropian;
MF	Ministria e Financave;
MSH	Ministria e Shëndetësisë;
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
MI	Ministria e Infrastrukturës;
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës;
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës;
KK	Kuvendi Komunal
SKQ	Sekretariati Koordinues i Qeverisë
PQ	Programi i Qeverisë
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
IP	Investime Publike
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
SVL	Strategjia për vetëqeverisje lokale
SKZH	Strategjinë Kombëtare për Zhvillim
PKRE	Programin Kombëtar për Reforma Ekonomike
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
PSAK	Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë

### 3. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal paraqet një dokument strategjik të bazuar në planin e veprimit, që ka për synim hartimin dhe koordinimin e politikave për zhvillim ekonomik lokal.

Ky dokument përcakton rrugën për të bërë realitet vizionin për komuna me qeverisje efikase, arsim cilësor, mjedis të pastër, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, ambient të përshtatshëm për biznes dhe bujqësi të zhvilluar me qëllim të ngritjes së cilësisë së jetesës.

Strategjia mbështet ngritjen e kapaciteteve qeverisëse duke përmirësuar zbatimin e ligjeve, krijimin e klimës së partneritetit me biznesin, krijimi i mundësive për aktivitete rinore dhe hapësira për grupet e marginalizuara, shoqërinë civile dhe qytetarët, që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e qeverisjes lokale.

Komunat shtrojnë para vetes qëllimet dhe objektivat në të cilat mbështeten në realizimin e kërkesave të qytetarëve për një mirëqenie më të mirë dhe padyshim në përputhje me buxhetin e përcaktuar. Këto synime janë shprehur përmes objektivave strategjike si në vijim:

- Objektiva strategjike nr.1: Rritja e qëndrueshmërisë financiare e komunave
- Objektiva strategjike nr.2: Tërheqja e investimeve të huaja
- Objektiva strategjike nr.3: Fuqizimi i ekonomisë lokale përmes investimit në kapitalin njerëzor
- Objektiva strategjike nr.4: Shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Hartimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal nuk është diçka e re për komunat e Republikës së Kosovës. Në përgjithësi komunat posedojnë strategjitë e tyre për zhvillim ekonomik lokal.

Edhe pse qeverisja lokale është ndërtuar mbi parimin e kartës evropiane për qeverisje lokale, vet qëndrueshmëria financiare e Komunave ende nuk është arritur. Komunat e Kosovës vazhdojnë të jenë të varura nga niveli qendror. Në shumtën e Komunave mbi 80% e buxhetit buron nga grantet qeveritare.

Vet qëndrueshmëria financiare është njëri ndër kriteret kryesore për t'u siguruar që niveli lokal, respektivisht komunat të kenë një zhvillim të qëndrueshëm për të krijuar mirëqenie për qytetarët.

#### 4. HYRJA

Marrë parasysh orientimet strategjike zhvillimore, Komunat do të bëjnë përpjekje që përmes zhvillimit ekonomik lokal të përmirësojnë dhe ngritin kualitetin e jetës së qytetarëve duke krijuar mundësi të reja në mirëqenien ekonomike dhe shoqërore. Kjo strategji trajton aspektet e zhvillimit ekonomik lokal të orientuara në drejtim të partneritetit me të gjitha palët e interesit me qëllim të rritjes së punësimit, uljes së nivelit të varfërisë dhe rritjes së cilësisë së jetesës. Zhvillimi ekonomik mund të arrihet vetëm kur komunat tregojnë qeverisje më të mirë dhe ofrojnë shërbime të nevojshme për publikun nëpërmjet përmirësimit dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në fushën e ekonomisë. Për të arritur këto qëllime, komunat fokus të veçantë duhet ti japin përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale, krijimit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin, promovimin e bizneseve të vogla dhe të mesme lokale, zhvillimi i sektorit të bujqësisë, nxitjen e krijimit të vendeve të reja punës përmes investimeve të reja qoftë nga vendi, e po ashtu edhe nga jashtë.

Strategjia ndërlidhet me një sërë dokumentesh strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës si: Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 (SVL); Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH); Programin Kombëtar për Reforma Ekonomike (PKRE) 2018; dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2018-2020 (KASH) Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2016.

Zhvillimi ekonomik i një vendi kërkon një sistem në të cilin respektohen plotësisht të drejtat pronësore dhe ku prona është komerciale ose e tregtueshme. Zhvillimi i ulët i tregut të pronës sot ndikon negativisht në shumë sektorë të ekonomisë, duke e përfshirë bujqësinë, ku konsolidimi i tokës dhe ekonomitë përkatëse të shkallës duhet të inkurajohen në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria. Të drejtat pronësore të

pazgjidhura janë po ashtu esenciale për qasje në financa, pasi që pronat do të mund të përdoren për kolateral.<sup>1</sup>

## 5. METODOLOGJIA

Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal është caktuar si një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në Planin e Veprimit 2015-2018 për Zbatimin e Programit të Qeverisë, planin e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017 si dhe koncept dokumentin për zhvillim ekonomik lokal i aprovuar me vendim të Qeverisë nr. 07/144 i datës 04.05.2017.

Për hartimin e kësaj strategji është themeluar Grupi Punues ndërministror, duke përfshirë institucionet si në vijim:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Zyra e Kryeministrit - Zyra për Planifikim Strategjik;
- Ministria e Integritit Evropian;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Infrastrukturës;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës;

Gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie, janë realizuar takime me komuna dhe institucione të tjera relevante. Po ashtu, strategjia ka kaluar procedurat e konsultimit paraprak dhe konsultimit publik në pajtim me rregullat për hartimin e dokumenteve strategjike.


---

<sup>1</sup> Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2021 (SKZH)

## 6. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE DHE SFIDAT KRYESORE

### 6.1 Nevoja për një sistem të qëndrueshëm që siguron zhvillim ekonomik lokal

Kosova ndodhet në një fazë të rëndësishme të zhvillimit kur politikat ekonomike duhet të jenë pjesë përbërëse programore në të gjitha fushat. Nga përvoja e deritanishme, zhvillimi ekonomik në nivel vendi, e sidomos në atë lokal, është ballafaquar me probleme dhe sfida të shumta, të cilat duhet të adresohen përmes planeve të veprimit. Tridhjetë e tetë komunat e themeluara plotësojnë mozaikun institucional përgjegjës për adresimin e politikave me ndikim në zhvillimin ekonomik, për të përmirësuar standardin e jetës dhe rritur mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve. Në hap me orientimet strategjike kombëtare për zhvillim dhe synimet nga agenda evropiane, koncepti i vetëqeverisjes lokale është duke u orientuar drejt një sistemi të decentralizimit funksional, ku përmes forcimit të kapaciteteve institucionale dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të komunave, synohet të krijohen kushte më të favorshme për zhvillim socio-ekonomik lokal.



Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, ku në mënyrë të precizuar përcaktohet edhe fusha e zhvillimit ekonomik lokal. Duke iu referuar bazës ligjore të lartëcekur, lirisht mund të themi se për të pasur zhvillim ekonomik lokal të qëndrueshëm në Kosovë, patjetër se duhet

të ketë komuna të forta të cilat ushtrojnë autorizime publike që ndikojnë në zhvillim ekonomik lokal. Në këtë kontekst, ndërtimi i politikave në nivelin lokal është parakusht kryesor për mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve.

Komunat janë përgjegjëse për të krijuar një klimë dhe ambient të favorshëm të të bërit biznes me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal. Për të pasur një zhvillim ekonomik lokal, është nevojshme të ketë një politikë gjithëpërfshirëse dhe të ndërtuar mirë, ku në të do të ngërtheheshin programe të ndryshme dhe të qarta, të cilat janë të ndara sipas fushave përkatëse, duke u nisur nga: investimi në resurset njerëzore, ruajtja dhe përparimi i bizneseve ekzistuese, tërheqja e bizneseve të reja, planifikimi dhe përcaktimi i zonave për investim, ofrimi i ambientit të sigurt dhe të përshtatshëm për investime direkte të huaja, adoptimin e teknologjive moderne, menaxhimin e resurseve dhe shfrytëzimin e tokës së pashfrytëzuar, si dhe shumë faktorë të tjerë të cilët ndikojnë dhe janë determinues në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë drejtim, hartimi i politikave të qarta dhe konkrete, si dhe procesi i planifikimit strategjik për zhvillimin ekonomik lokal, realizohet përmes kulturës së përbashkët të punës ndërmjet njerëzve dhe formimit të partneriteteve afatgjata. Po ashtu, këto elemente thelbësore mundësojnë një rritje të qëndrueshme ekonomike, ku përfitimet ekonomike, përmirësimi i kushteve dhe i cilësisë së jetës së të gjithë qytetarëve, pa dallim, do të ishte thelbësorë dhe i dukshëm. Prandaj, në këtë fazë të re të zhvillimit, nevojitet një qasje e re ndaj politikave zhvillimore në nivel lokal. Kjo qasje e re adreson të gjithë faktorët (faktorët e jashtëm dhe të brendshëm) që kufizojnë rritjen ekonomike.

Në bazë të të dhënave ekzistuese, komunat kanë vështirësi të shumta për sa i përket rolit të tyre në politikat e zhvillimit ekonomik lokal. Lidhur me këtë kanë ndikuar shumë faktorë, si: resurset e pamjaftueshme financiare, zhvillimi i ulët ekonomik në nivel vendi, mungesa e kapaciteteve profesionale, dëmet në ekonominë e pasluftës, problemet pronësore, mungesa e shërbimeve të domosdoshme për jetë, siç janë: uji, kanalizimi, rrugët, objektet shkollore, rekreative, etj<sup>2</sup>. Të gjitha këto kanë shkaktuar pengesat dhe kanë kufizuar mundësitë e komunave për realizimin e projekteve zhvillimore, ngecje në ekonominë lokale dhe thellim të papunësisë në vend. Duke marrë parasysh normën e lartë të papunësisë në Kosovë, e cila gjeneron

---

<sup>2</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: "Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026", Prishtinë, Shkurt, 2016



varfëri dhe që ndikon në cilësinë e dobët të jetesës, nevojitet krijimi i platformave të reja për rridefinimin e rolit të komunave në këtë drejtim.

Të dhënat statistikore në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) në Kosovë, në tremujorin e dytë të vitit 2017 tregojnë të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, gjendjen e punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe fushave të tjera të tregut të punës. Në tremujorin e dytë të 2017, shkalla e punësimit është 29.9 %, shkalla e papunësisë është 30.6 % ndërsa shkalla e jo aktivitetit është 57.0 %. Të dhënat e AFP-së tregojnë që përqindja e personave të punësuar me orar të pjesshëm për tremujorin e dytë të këtij viti është 6.2 %. Vetëpunësimi (si përqindje e të punësuarve) për këtë tremujor është 24.0 %. Përqindja e të punësuarve në punë të paqëndrueshme (personat, që janë të vetëpunësuar dhe nuk kanë punonjës dhe ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar) ishte 24.0 %. Tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe arsimit vazhdojnë të punësojnë pothuaj gjysmën e personave të punësuar. Sa i përket pjesëmarrjes në fuqinë punëtore që është 43.0 % në këtë periudhë, numri i femrave që i përkasin fuqisë punëtore ishte 20.0 % ndërsa meshkuj ishte 65.7 %. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 50.9 %. Papunësia afatgjate e të rinjve (15-19), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj për këtë tremujor është 50.0 %. Përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as në trajnim – NEET (të intervistuarit e moshës 15-24 vjeç), është 27.1 %.<sup>3</sup>

Duke parë parasysh këtë normë kaq të shprehur, Strategjia për zhvillim ekonomik lokal synon të adresoj zgjidhje për përmirësimin e politikave për zhvillim ekonomik lokal duke rritur kapacitetet ligjore dhe funksionale të komunave për të dhënë rezultate në rritjen ekonomike në nivel lokal.

## **6.2 Sfidat kryesore të komunave që duhet të adresohen**

Komunat përballen me sfida të shumta në fushën e zhvillimit ekonomik lokal ndër të cilat veçohet varësia e madhe buxhetore e nivelit lokal nga grantet qeveritare me rreth 85% si dhe mungesa e hapësirave biznesore përfshirë numrin e kufizuar të zonave ekonomike (janë ndërtuar zona ekonomike në rajonin e Prishtinës–Glllogoc, rajonin e Prizrenit– Suharekë, rajonin e Ferizajt-Shtime, si dhe në Mitrovicë).

---

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës: Seria 5: Statistikat Sociale Anketa e Fuqisë Punëtore TM2 - 2017

Gjithashtu, sfidë mbetet klima jo shumë e favorshme në nivel lokal për joshjen e investimeve të huaja direkte, mungesë të strategjive lokale për fuqizim të kapitalit njerëzor me nevojat e tregut të punës, mungesë e një baze të dhënave për investitorë të huaj për investime në komuna, kuadër ligjor që kufizon në masë të madhe huamarrjen komunale, si dhe probleme të tjera të natyrës ligjore dhe administrative.

Pavarësisht projeksioneve të normës së rritjes ekonomike në shkallën prej 4.3% për vitin 2018<sup>4</sup>, mundësitë e komunave për të ndikuar në rritjen ekonomike në masë të madhe janë të limituara. Një ndër problemet për shfrytëzimin e potencialit ekonomik të komunave, ka të bëjë edhe me menaxhimin e pronës komunale. Procedurat e deritanishme të ofrimit të tregut të pronës në funksion të zhvillimit ekonomik janë të tejzgjatura dhe shkaktojnë probleme praktike, gjë që kërkojnë rishikimin e infrastrukturës ligjore në këtë fushë. Gjithashtu, një pjesë e komunave nuk disponojnë me pronë komunale, ndërsa mosdefinimi i qartë i konceptit të pronës publike, shtetërore, komunale dhe shoqërore ka shkaktuar konfuzion në komuna dhe shpeshherë veprime juridike në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm. Mirëpo, zgjidhja e kësaj çështje mbetet të zbatohet konform Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë. Në këtë kontekst, "procesi i privatizimit i ka pamundësuar komunës që të menaxhoj tokat që kanë qenë në pronësi shoqërore. Për pasojë është kufizuar fondi i pasurisë së paluajtshme të komunave dhe në disa raste kjo ka sjellë vështirësi në implementimin e planeve zhvillimore komunale"<sup>5</sup>. Ky proces mund të lehtësohet përmes rishikimit të kornizës ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Realizimi i projekteve strategjike të komunave duhet të bëhet përmes thjeshtimit të procedurave për përdorim të pronës komunale në raport me investitorët potencial. Kosova ka hartuar kornizë ligjore për investime strategjike e cila mundëson nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike. Komunitat duhet të planifikojnë fondin e tokave për dhënie në shfrytëzim dhe të ofrojnë kushte dhe infrastrukturë përcjellëse në pronat komunale, për të mundësuar realizimin projekteve strategjike në nivel lokal.

---

<sup>4</sup> KASH 2018-2020

<sup>5</sup>Republika e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: "Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026", Prishtinë, Shkurt, 2016

**Arsimi** - Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) përcakton kornizën e bashkëpunimit të Kosovës me BE-në për ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, me qëllim të përmirësimit të shkathtësive, punësueshmërisë, përfshirjes sociale dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik. MSA i kushton kujdes të veçantë bashkëpunimit për arritjen e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim, me theks të veçantë, gjininë, përkatësinë etnike dhe fetare, si dhe personat me aftësi të veçanta. Pritet që bashkëpunimi në mes të BE-së dhe Kosovës të marrë formën e asistencës teknike për jetësimin e masave të caktuara të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK-ut).

Sistemi i arsimit duhet t'i përshtatet kërkesave të tregut vendor dhe evropian të punës, duke u përqendruar në ngritjen e cilësisë, në mënyrë që të diplomuarit t'i përmbushin standardet e punëdhënësve.

Në një kohë kur papunësia në vend është shumë e lartë, paradoksi është se shumë ndërmarrje kanë problem të gjejnë kuadër deficitar. Një ndër shkaqet kryesore qëndron te sistemi i arsimit, gjegjësisht tek përfshirja e ulët e fëmijëve në programe parashkollore (25-30% e fëmijëve janë të përfshirë dhe dallimet janë të mëdha nga zonat urbane dhe rurale) dhe tek cilësia e mësimdhënies. Problem tjetër gjithashtu përbën mungesa e përputhshmërisë së aftësive dhe shkathtësive të fituara me kërkesat e tregut të punës, teksa mungojnë lidhjet në trekëndëshin ndërmjet shkollave, bizneseve dhe komuniteteve<sup>6</sup>. Komunitet duhet të përqendrohen në përmirësimin e kushteve për zhvillim të arsimit para fillor, fillor dhe të mesëm, rregullimin e infrastrukturës së nevojshme shkollore, hapjes së shkollave profesionale, përmirësimin e cilësisë në arsim, monitorimin e procesit arsimor, përzgjedhjen meritorë të stafit arsimor dhe menaxherial, si dhe përpjekjen në ngritjen e kapaciteteve të vazhdueshme të kuadrit arsimor. Gjithashtu, fokusi i komunave duhet të orientohet në "aftësimin e të rinjve si fuqi punëtore, përmes formave të arsimit alternativ, hapjes së qendrave inovative për të rinj, programeve të trajnimit dhe inovacion<sup>7</sup>.

**Shëndetësia** - Analiza e gjendjes aktuale të sistemit shëndetësor ka paraqitur nevojën e zhvillimit të ndryshimeve dhe zbatimit të reformës në sistemin shëndetësor, qoftë në aspektin e riorganizimit të sistemit aktual dhe institucioneve gjegjëse, ashtu edhe në sigurimin e

---

<sup>6</sup> Republika e Kosovës: "Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021", Prishtinë, Janar, 2016

<sup>7</sup> Plani i Veprimtari të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale, 2016-2026.

qëndrueshmërisë financiare të sistemit. Karakteristikat demografike të popullatës orientojnë zhvillimin e sistemit shëndetësor kah ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës, duke fuqizuar kujdesin parësor si shtyllë të sistemit shëndetësor, në veçanti promovimin e mënyrave të shëndetshme të jetesës.

Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të listës prioritare të projekteve ka inkorporuar edhe projektin për fuqizimin e infrastrukturës në kujdes parësor. Veprimtaria e kujdesit parësor shëndetësor përfshin promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike mbështetur në konceptin e mjekësisë familjare. Rrjeti publik i KPSH-ve përbëhet nga gjithsej 429 institucione, nga të cilat secila komunë e Kosovës ka Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi kryesore, me njësi të saja përbërëse: Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF). Sa i përket zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore në mjekësi familjare, të arriturat janë evidente. Në këtë aspekt ka “ngritje në zhvillimin e resurseve profesionale njerëzore dhe cilësisë së shkollimit specialistik post-diplomik, i cili është program i akredituar ndërkombëtarisht. Mbikëqyrja dhe sigurimi i cilësisë së zbatimit të programit bëhet nga Kolegji Mbretëror i Mjekëve të Përgjithshëm nga Britania e Madhe”<sup>8</sup> KPSH-të financohet përmes transfereve nga buxheti qendror në komuna në formë të grantit specifik shëndetësor, në një përqindje mesatare prej 28 % të buxhetit total të ndarë për shëndetësi.

**Infrastruktura** - Krijimi i ambientit për zhvillim të sigurt, kualitativ dhe funksional të sistemeve të infrastrukturës dhe të kapaciteteve njerëzore për ofrimin e shërbime cilësore, ndikon për mjedis të pastër ekologjik dhe rritje ekonomike. Komuna angazhohet për krijimin e një sistemi plotësisht të integruar të transportit për të gjithë qytetarët, i cili do t’u mundësojë atyre të zgjedhin transportin më efikas dhe më të leverdishëm që plotëson nevojat e tyre, që garanton ruajtjen e mjedisit.<sup>9</sup>

Komunat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen, organizimin, operimin dhe zhvillimin e rrjetit rrugor të tyre.

**Bujqësia** - si një sektor me rëndësi të veçantë merr pjesë me rreth 63% të ekonomisë së popullsisë që jeton në zona rurale dhe kontribuon në forma të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe në rritje të punësimit. Bujqësia si formë e veçantë me

---

<sup>8</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës: “Strategjia sektoriale për shëndetësi 2017-2021”, Prishtinë, 2016

<sup>9</sup> Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015- 2025

potencial për zhvillim ekonomik lokal, gjen hapësirë të veçantë për realizimin të objektivave në këtë strategji, kur dihet se edhe në nivel të bruto produktin vendor (BPV) bujqësia merr pjesë me 10.5%. Përkrahja e sektorit të bujqësisë nga niveli qendror dhe lokal bëhet përmes pagesave direkte dhe granteve nga sektori i bujqësisë për fermerë Bujqësia ka arritur që të ketë zhvillim më të madh, pasi që masat e zhvillimit rural kanë kontribuar në vetëpunësim dhe njëherësh rritjen e mirëqenies dhe cilësisë së jetës<sup>10</sup>. Ndër sfidat kryesore me të cilat përballlet sektori i bujqësisë janë: sipërfaqe të vogla prodhuese, azhurnimi i rregullt i regjistrit të fermës, numri i madh i fermerëve me sipërfaqe të vogël të ngastrave, pronësia e tokave bujqësore, ruajtja e destinimit të tokës bujqësore dhe konsolidimi i tokës për nevoja të zhvillimit të bujqësisë.

**Turizmi** - Në shumë vende të botës turizmi është një sektor mjaft i rëndësishëm për zhvillim ekonomik. Përmes turizmit mund të sjellim investime të huaja, të joshim investitorë të rinj, të joshim turistë duke iu ofruar qasje në pasuritë dhe bukuritë natyrore, qasje në shërbime, qasje në vlera të tjera turistike, trashëgiminë kulturore etj. Ndikimi direkt i turizmit sjell shtim të të hyrave, zhvillim të veprimtarive ekonomike që përbëjnë ekonominë turistike përfshirë: hotelerinë, transportin, tregtinë, institucionet kulturore, rritjen e punësimit, standardit jetësor, investimet, zhvillimin e viseve të pazhvilluara. Në anën tjetër, turizmi ka ndikim indirekt në ato ekonomi të cilat furnizojnë ekonominë turistike, duke përfshirë: bujqësinë, ndërtimtarinë, industrinë artizanale. Prandaj, duke parë rëndësinë kaq të madhe të sektorit të turizmit, kjo degë duhet të zhvillohet dhe promovohet më tepër nga komunat në mënyrë që të shfrytëzohen format të ndryshme të zhvillimit të turizmit, përfshirë: turizmin malor, kulturor (festat artistike, panairot, koncertet, festivalet, muzeumet), turizmi familjar, turizmin rinor, dimëror, ekoturizmin.

Ndër sfidat kryesore në fushën e turizmit, janë: identifikimi i zonave potenciale turistike, kompletimi i infrastrukturës përcjellëse në zonat me potencial turistik, promovimi i turizmit (pikat e kontaktit në komuna për turistë).

---

<sup>10</sup> Programi për zhvillim rural dhe bujqësor 2014-2020 i Republikës së Kosovës

### **6.3 Politikat strategjike për zhvillim ekonomik lokal**

Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 - theksohen një numër masash të ndërlidhura ngushtë me kompetencat e komunave që duhet të ndërmerren për të siguruar një sistem të qëndrueshëm të politik bërjes dhe zbatim më efektiv. Kompletimi i kornizës së dokumenteve hapësinore në nivel lokal, menaxhimi efikas i shërbimeve publike, planifikimi më i mirë i politikave, përgatitja e kapitalit njerëzor, promovimi i rëndësisë së shkollave profesionale dhe ndërlidhja e shkollimit me tregun e punës, shpenzimi i drejtë i parasë publike, promovimi i tregut të tokës dhe resurseve të tjera që mundësojnë rritje ekonomike janë disa nga qasjet që kërkojnë adresim në një periudhë të ardhshme të veprimit. Prandaj, është me rëndësi të krijohet një qasje koherente në mes të synimeve afatgjata me strategji afatmesme, përmes së cilave do të mund vendosen caqet specifike për rregullim të një politike të caktuar, siç është zhvillimi ekonomik lokal.

Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026 - Zhvillimi ekonomik lokal është ngritur si temë e veçantë përmes Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji parasheh masa multisektoriale në drejtim të fuqizimit të sistemit të vetëqeverisjes lokale, duke nënkuptuar edhe alternativat për rritjen e autorizimeve të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal. Me aprovimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit janë dhënë orientimet afatgjata programore për nivelin qendror dhe atë lokal, për të rikonfirmuar rëndësinë e pushtetit lokal si një mekanizëm i pazëvendësueshëm në zgjidhjen e problemeve praktike të qytetarëve. Përmes objektivit të parë të kësaj strategjie, atë për zhvillim ekonomik lokal, synohet që përgjatë viteve në vijim të krijohen politika efektive në favor të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të komunave. Strategjia identifikon problemet e komunave të përcjella ndër vite dhe shtron nevojën për hartimin e politikave zhvillimore nga niveli qendror për ndryshimin e bazës ligjore të financimit të komunave, koncentrimin e komunave në projekte zhvillimore të koordinuara me prioritetet strategjike në nivel vendi dhe atyre lokale, për investime në kompletimin e infrastrukturës rrugore dhe zgjerimit të rrjetit të transportit lokal, fuqizimin e kapitalit njerëzor dhe ndërlidhjes së fuqisë punëtore me tregun e punës, si dhe forma të tjera të përkrahjes së bizneseve.

Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së - Duhet të theksohet se nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asociim ndërmjet BE-së dhe Kosovës, ka hapur rrugën për reforma institucionale dhe krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Arritjet në zbatimin më të suksesshëm të kësaj marrëveshjeje dhe reformave të parapara janë lehtësuar përmes Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA). Ndër masat afatshkurtra të përcaktuara në këtë dokument politikash në mes tjerash parashihen: sigurimi i përmirësimit të veprimtarisë së organeve lokale në përmbushjen e mandatit të tyre ligjor, sigurimi i zbatimit të ligjshmërisë me rastin e veprimtarisë së tyre normative, fuqizimi i transparencës komunale, zbatimi efikas i projekteve kapitale, nxitja e zhvillimit përmes programeve të bashkëpunimit ndërkomunal, ndërkufitar dhe transnacional, forcimi i kapaciteteve të administratës lokale etj<sup>11</sup>. Të gjitha këto nevojiten të jenë fokus i kësaj strategjie dhe adresohen masa të përshtatshme të veprimit, në mënyrë që komunat të kenë rolin e tyre të rëndësishëm për një ambient të përshtatshëm për zhvillim të bizneseve dhe investime të reja.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) - është një dokument i cili rishikohet dhe miratohet çdo vit nga Kuvendi i Komunës. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Shpenzimet duhet të planifikohen për të pasqyruar prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KABK siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuar në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Strategjitë e veprimit në nivel lokal- Duke marrë për bazë specifikat dhe kapacitetet zhvillimore, 34 komuna kanë hartuar strategjitë për zhvillim ekonomik lokal, përveç komunave: Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore. Shumica nga këto strategji nuk kanë qenë në harmoni me KASH-in dhe prioritetet e qeverisë, për shkak të kufizimeve buxhetore. Me gjithë këtë, komunat kanë bërë përpjekje që përmes realizimit të zotimeve të tyre periodike, të përmirësojnë dhe rrisin kualitetin e jetës së qytetarëve, duke ofruar mundësi të reja për operim të bizneseve, nxitjen e

---

<sup>11</sup> Republika e Kosovës, Qeveria: *Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA)*, Mars, 2016, fq 26.

prodhimitarisë e sidomos sektorit bujqësor (i cili gjeneron punësim sezonal), kushte për qarkullim më të mirë të mallrave dhe njerëzve, përmirësimin e standardit jetësor, mbështetje për kategoritë e caktuara shoqërore, si dhe formave të tjera të mbështetjes së veprimtarive ekonomike e sociale.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës përqendrohet në katër shtylla kryesore: sundimi i ligjit; zhvillimi ekonomik dhe punësimi; politika e jashtme dhe integrimi euro - atlantike dhe zhvillimi sektorial.<sup>12</sup>

**Tabela 1. Agregatet kryesor makroekonomik<sup>13</sup>**

Përshkrimi	2015	2016 Vler.	2017 Proj.	2018 Proj.	2019 Proj.	2020 Proj.
<b>Normat reale te rritjes (ne për qind)</b>						
BPV	4.1%	3.6%	4.1%	4.3%	4.3%	4.0%
BPV për koke banori	3.9%	3.4%	3.9%	4.1%	4.1%	3.8%
Konsumi	0.6%	3.2%	2.2%	3.4%	3.6%	3.0%
Investimet	11.3%	7.8%	8.5%	7.1%	5.9%	5.3%
Eksporti	16.8%	6.2%	1.3%	2.5%	2.6%	2.4%
Importi	6.2%	6.3%	1.4%	3.5%	3.1%	2.1%
<b>Ndryshimet e çmimeve (ne për qind)</b>						
ICK	-0.5%	0.3%	1.5%	1.1%	0.9%	0.9%
Deflatori	0.2%	0.6%	1.3%	1.2%	0.9%	0.8%
Çmimet e Importit	-1.0%	-2.5%	3.8%	1.5%	1.5%	1.5%
<b>Bilanci i kursimeve/investimeve (ne % te BPV-se)</b>						
Neto te ardhurat parësore nga jashtë	1.3%	1.1%	1.5%	1.6%	1.7%	1.6%
Neto te ardhurat dytësore nga jashtë	18.3%	17.8%	17.5%	17.1%	16.8%	16.5%
<i>prej te cilave: remitancat</i>	11.5%	11.4%	11.1%	10.9%	10.6%	10.4%
Investimet	27.6%	27.9%	29.6%	30.4%	31.0%	31.8%
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	-8.8%	-9.4%	-9.3%	-9.8%	-10.2%	-10.5%
Bilanci tregtar	-36.3%	-37.9%	-37.8%	-37.9%	-38.0%	-37.8%
Bruto kursimet kombëtare	18.8%	18.6%	20.3%	20.6%	20.8%	21.3%
Kursimet private	15.3%	13.5%	15.3%	15.0%	14.7%	14.5%
<b>Agregatët kryesor (në miliona euro)</b>						
BPV	5,807	6,051	6,380	6,726	7,080	7,424
BAKD	6,947	7,197	7,593	7,989	8,389	8,778
PBV për capita (ne euro)	3,211	3,339	3,513	3,697	3,884	4,064
BAKD për capita (ne euro)	3,622	3,757	3,957	4,159	4,362	4,557
Remitancat e punëtoreve	665	691	710	730	751	772
Popullsia (ne mijëra)	1,809	1,812	1,816	1,819	1,823	1,827

<sup>12</sup>Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021

<sup>13</sup> KASH 2018-2020



Remitancat për vitin 2014 ishin 622.3 milion€, për vitin 2015 ishin 665.4 milion € dhe për vitin 2016 ishin 691.0 milion€ <sup>14</sup>.

#### **6.4 Investimet në nivel lokal**

Aktualisht koordinimi i nivelit qendror dhe nivelit lokal për planifikimin të investimeve nuk është në nivelin e duhur.

Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet politikave zhvillimore do të mundësonte joshjen e investimeve të bizneseve në nivel lokal, sidomos në sektorin e prodhimit dhe në sektorin e shërbimeve, ndikon në shtimin e vlerës së tyre. Zhvillimi i politikave në nivel lokal rrit kapacitetet prodhuese, krijon vende të reja të punës, si dhe ndikon në zhvillimin e politikave sektoriale që komunat të jenë vend i përzgjedhur për investime.

Në këtë drejtim, rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) bënë që ekonomia lokale t'i mbulojë nevojat financiare dhe të krijojë kushte më të mira jetësore për qytetarët. Kjo nënkupton se një biznes i huaj duhet të gjejë mbështetje konkrete nga komunat me qëllim të investimit në nivelin lokal.

Bashkëpunimi në mes të nivelit qendror dhe atij lokal në lidhje me zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe me marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit lidhur me mundësinë e investimeve të huaja, do tu lehtësonte investitorëve të huaj qasje më të lehtë, si dhe krijimin e kushteve më të favorshme për investime në komuna.

#### **6.5 Burimet e financimit të komunave**

Burimet financiare të një komune përbëhen nga: të hyrat vetanake të komunës, grantet qeveritare, grantet e donatorëve të jashtëm dhe huamarrja komunale.

Të hyrat vetanake komunale - janë mjetet financiare që mbliidhen nga taksat, tarifat, gjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkë pagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj. <sup>15</sup>.

Realizimi i të hyrave për vitin 2016 ka qenë 71,025,872.71€, nëse krahasojmë me planifikimin (79,622,353.00), realizimi është 89%. Të hyrat që kanë një ndikim më të

---

<sup>14</sup> Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017

<sup>15</sup>Ligji nr. 03/1-049 për financat e pushtetit lokal

madh në rritjen e të hyrave vetanake janë tatimi ne pronë i cili gjatë vitit 2016 është inkasuar në shumë prej (25,436,643 €); që është një inkasim më i madh se në periudhën e njëjtë të vitit 2015 (19,914,321 €); dhe të hyrat komunale për leje ndërtimi ku gjatë vitit 2016 është inkasuar shuma prej (17,293,233 €) që është një inkasim me i madh se gjatë periudhës se njëjtë të vitit 2015 (12,020,331 €); ndërsa të hyrat nga ndërrim destinim i tokës ne vitin 2016 ka inkasuar (1,707,936€)ka pas ulje krahasuar me vitin 2015 (2,022,868€).

Trendet e të hyrave sipas KASH-it

2015 Aktuale	2016 Buxheti	2017 Plani	2018 Vlerësimi	2019 Vlerësim
74,198,213	79,963,78	78,163,490	78,712,500	80,000,000

Komunat pranojnë Grante Operative nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës. Grantet Operative janë: Grantet e Përgjithshme, Grantet Specifike për Arsim dhe Grantet Specifike për Shëndetësi.

**Granti i përgjithshëm** - Komunat pranojnë një Grant të Përgjithshëm të cilin mund ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të tyre komunale. Shuma e Grantit të Përgjithshëm është 10% e të hyrave totale të buxhetuara të qeverisë qendrore. Pjesa e mbetur e Grantit të Përgjithshëm ju alokohet komunave në përpjesëtim me: (89%); numri i popullsisë pakicë me tre për qind (3%); komunat, shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy për qind (2%); dhe përmasat gjeografike me gjashtë për qind (6%). Përcaktimi i shumës së Grantit Specifik për Arsim dhe një Grantit Specifik për shëndetësi bazohet në një qasje të hapur të financimit.<sup>16</sup>

**Grantet Specifike për Arsim dhe Shëndetësi** - Komunat do të pranojnë një Grant Specifik për Arsim dhe një Grant Specifik për Shëndetësi. Përcaktimi i shumës së këtyre granteve bazohet në një qasje të hapur të financimit. Granti Specifik për Arsim përdoret për financimin e kostos së ofrimit të nivelit të standardit minimal të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm. Granti Specifik për Shëndetësi përdoret për

<sup>16</sup> Ligji nr. 03/1-049 për financat e pushtetit lokal

financimin e kostos së ofrimit të nivelit të standardit minimal të shëndetësisë publike primare.<sup>17</sup>

Investimet kapitale në komuna - Pjesa e investimeve kapitale për vitin 2016 të buxhetuara dhe të shpenzuara dhe planifikimi për vitin 2017 sipas klasifikimit funksional i cili ka filluar të aplikohet nga viti 2016.

KLASIFIKIMI FUNKSIONAL I PROJEKTEVE KAPITALE PËR VITIN 2016-2017					
	Kodet funksionale	Buxheti 2016	Shpenzimet	Përqindja	Buxheti i planifikuar për vitin 2017
0111	Organet legjisl.dhe ekzekutive	431,479	243,397	56.4%	708,510
0112	Çështjet financiare dhe fiskal	7,132,973	4,337,347	60.8%	4,875,421
0133	Shërbimet tjera të përgjith.	4,857,482	3,389,333	69.8%	5,286,448
0320	Shërb.e mbrojtjes nga zjarri	328,748	133,358	40.6%	398,000
0411	Qesht.e	4,440,761	3,057,518	68.9%	5,524,636
	pergj.eko.komerc□punës				
0421	Bujqësia	4,173,959	2,802,026	67.1%	5,013,715
0422	Pylltaria	75,000	43,410	57.9%	120,678
0451	Transporti rrugor	51,494,503	39,744,166	77.2%	54,591,321
0473	Turizmi	1,639,463	938,137	57.2%	1,262,000
0610	Zhvillimi i banimit	1,211,518	561,497	46.3%	1,636,663
0620	Zhvillimi i komuniteteve	20,792,897	16,828,869	80.9%	23,423,213
0721	Shërb.e përgj.mjekësore	3,998,215	3,161,992	79.1%	5,077,050
0722	Shërbimet e	478,129	467,729	97.8%	926,002
	specializimit.mjekësorë				
0760	Shëndet.e paspecifik.tjetër.	355,108	235,674	66.4%	479,857
0810	Shërbimet e sportit□rekreacio.	425,000	289,861	68.2%	600,000
0820	Shërbimet kulturore	3,351,130	2,008,975	59.9%	3,904,924
0911	Arsimi parashkollor & fillor	438,583	281,233	64.1%	755,836
0912	Arsimi primar	4,282,277	2,302,436	53.8%	4,887,877
0922	Arsimi i mesëm i nivelit lartë	1,424,982	1,424,157	99.9%	1,788,278
0980	Arsimi i padefinuar	5,599,580	4,138,348	73.9%	7,677,767
1040	Familja dhe fëmijët	953,023	715,021	75.0%	1,196,000
1060	Strehimi	68,207	68,197	100.0%	286,920
1090	Mbrojtja sociale paspecifikuar	348,059	260,406	74.8%	417,000
		118,301,077	87,433,084	73.9%	130,838,117

*Pasqyra e investimeve kapitale për vitin 2016-2017 sipas klasifikimit funksional*

<sup>17</sup> Ligji nr. 03/l-049 për financat e pushtetit lokal

*Projeksionet për investime kapitale në komuna*

Projeksionet 2017	Projeksionet 2018	Projeksionet 2019
129,688,117	136,802,950	145,466,577

Shpenzimet kapitale do të përbëjnë afro 13.5% të BPV-së deri në vitin 2020. Shpenzimet për periudhën 2018-2020 parashikohen të rriten në vazhdimësi, duke arritur 2,485 milion euro në vitin 2020; një ngritje prej rreth 7% në mesatare. Duhet theksuar se kjo rritje vjen kryesisht nga rritja në shpenzimet kapitale, të cilat parashihen të rriten në masën prej 14% në mesatare për periudhën e ardhshme afatmesme<sup>18</sup>.

Shpenzimet kapitale planifikohet të paraqesin përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale qeveritare në raport me të kaluarën. Shpenzimet kapitale përgjatë periudhës afatmesme pritet të përfaqësojnë rreth 41% të shpenzimeve totale apo një mesatare prej rreth 14% të BPV-së për periudhën 2018-2020.<sup>19</sup>

Gjegjësisht, çdo euro shpenzuar në shpenzimet operative balancohet me reduktim të një euro në shpenzimet kapitale. Përderisa politika ekonomike kombëtare në Kosovë i jep përparësi shpenzimeve në investime, në nivelin komunal ekuilibri midis shpenzimeve operative dhe atyre në investime mund të jetë i ndryshëm nga komuna në komunë. Qeveria duhet të informoj komunitat për politikën e përgjithshme të zhvillimit lokal, komunitat duhen të "përshtatin" këtë politik të përgjithshme me atë specifike lokale.

Është e rëndësishme që të hyrat e grumbulluara nga komunitat të rikthehen tek qytetarët në formën më të mirë të mundshme të ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe më cilësore, pra t'iu dëshmohet qytetarëve se menaxhimi i mjeteve të tyre financiare është transparent dhe që përdoret për shërbime afër tyre.

Adresimi i këtyre sfidave bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet nivelit qendror dhe nivelit lokal, duke zhvilluar politika sektoriale të cilat ndikojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal si:

- Rishikimi i formulës së financimit të pushtetit lokal, zhvillimi i kriterëve për financim lokal, bartje e kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal në

<sup>18</sup> KASH 2018-2020

<sup>19</sup> KASH 2018-2020

fushën e buxhetimit, krijimi i mundësive më të mëdha për rritjen e të hyrave vetanake me qëllim të uljes së varshmërisë buxhetore nga niveli qendror;

- Niveli qendror të krijoj kushte të nevojshme me qëllim të funksionalizimit të zonave ekonomike me qëllim të balancimit të të gjitha komunave të cilat me fuqizimin e tyre do të ndikojnë në rritje ekonomike, fushatave për sensibilizim të bizneseve etj;
- Niveli lokal duhet të jetë më i informuar në lidhje me mundësitë e investimeve të huaja dhe të trajtoj këtë çështje me prioritet në mënyrë që investitorët të kenë adresa të qarta në lidhje me interesat e tyre;
- Të arrihet një përafrim i nivelit qendror dhe lokal në fushën e huamarrjes komunale përmes rishikimit të legjislacionit dhe rritjen e performancës pozitive të komunave karshi opinioneve të auditimit.

## 6.6 SWOT ANALIZA


<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përparësitë:</li> <li>- Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040; Ligji për financa të pushtetit lokal; Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 (SVL);Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH); Programin Kombëtar për Reforma Ekonomike (PKRE) 2015; Koncept dokumentin për zhvillim ekonomik lokal i aprovuar me vendim të Qeverise nr. 07/144 i datës 04.05.2017;</li> <li>- Korniza afatmesme buxhetore komunale (KABK);</li> <li>- Komunat kane kapacitete për hartimin e strategjive komunale;</li> <li>- Komunat kanë kompetencë vetanake zhvillimin e infrastrukturës publike e cila i përmbushë nevojat e qytetarëve dhe bizneseve;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dobësitë:</li> <li>- Inkasimi i ulët i të hyrave komunale,</li> <li>- Menaxhim jo racional i buxheteve komunale;</li> <li>- Centralizimi i të hyrave vetanake;</li> <li>- Strategjitë e komunave nuk janë të harmonizuara me politikat e nivelit qendror;</li> <li>- Infrastruktura publike lokale nuk i përmbushë mjaftueshëm nevojat e             <ul style="list-style-type: none"> <li>- qytetarëve dhe bizneseve;</li> </ul> </li> <li>- Funksionimi i shërbimeve elektronike në kuadër të QSHQK-ve (funksionimi i intranetit) për qytetarë dhe biznese në nivel jo të kënaqshëm në disa komuna;</li> <li>- Menaxhim jo adekuat i pronës komunale për qëllim të zhvillimit ekonomik lokal;</li> <li>- Pengesat ligjore për inkasimin e të hyrave nga shfrytëzimi i pasurive natyrore;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mundësitë :</li> <li>- Ngritja e kapaciteteve në nivel</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rreziqet:</li> <li>- Buxhetet e limituara komunale;</li> </ul>

<p>lokal për resurset njerëzore me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planifikimi i pavarur i të hyrave vetanake pa ndikim nga niveli qendror;</li> <li>- Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake;</li> <li>- Ngritja e vetëdijesimit i qytetarëve për kryerjen e obligimeve ndaj shërbimeve të pranuar nga komuna;</li> <li>- Rishikimi i politikave fiskale aktuale përmes ndryshimit të kornizës ligjore;</li> <li>- Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal si dhe binjakëzimi i komunave të Republikës së Kosovës me komunat e shteteve tjera, me qëllim të shkëmbimit të përvojave për zhvillim ekonomik lokal;</li> <li>- Fuqizimi i partneriteti publiko privat;</li> <li>- Menaxhimi i duhur efektiv i pronës komunale me destinim të zhvillimit ekonomik;</li> <li>- Nxitja e investimeve të huaja direkte duke ofruar lehtësira në shërbimet komunale;</li> <li>- Përkrahja e komunave që kanë performancë më të mirë;</li> <li>- Realizimi i huamarrjes komunale;</li> <li>- Ofrimi i shërbimeve në formë elektronike;</li> <li>- Inkasimi i të hyrave nga shfrytëzimi i pasurive natyrore;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Inkasimi jo i kënaqshëm i të hyrave vetanake komunale;</li> <li>- Mosimplementimi i strategjive ekzistuese për zhvillim ekonomik lokal;</li> <li>- Mos funksionalizimi i ndërmarrjeve të privatizuara;</li> <li>- Zvogëlimi i interesimit të donatorëve për investime;</li> <li>- Mungesa e investimeve dhe mirëmbajtja e tyre në infrastrukturën publike lokale;</li> </ul>
---	---

## **7. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE**

### **7.1 Vizioni**

Krijimi i politikave për zhvillim ekonomik lokal për të siguruar një qëndrueshmëri të ekonomisë lokale, në mënyrë që të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në të gjitha fushat.





## 7.2 Objektivat strategjike

### Objektivi strategjik nr.1: Qëndrueshmëria financiare e komunave.

Qëndrueshmëria financiare është njëri ndër kriteret kryesore për t`u siguruar që niveli lokal, respektivisht komunat të kenë një zhvillim të qëndrueshëm për të krijuar mirëqenie për qytetarët. Në Republikën e Kosovës në bazë të ligjeve në fuqi buxheti rregullohet nga niveli qendror, dhe vetëm disa aspekte të bërjes së buxhetit delegohen në nivelin komunal. Pavarësisht këtyre kufizimeve që burojnë nga legjislacioni aktual, komunat e Republikës së Kosovës e kanë mundësinë që së paku të hyrat vetanake t`i shpenzojnë sipas nevojës së tyre.

- **Objektivi specifik 1.1.** Zvogëlimi i varësisë buxhetore të komunave nga niveli qendror përmes rishikimit të formulës së financimit.

Për realizimin e kësaj objektive komunat duhet të krijojnë kushte për rritjen e shkallës së pavarësisht buxhetor në mesatare të përgjithshme deri në 30%-40% duke e zgjeruar gamën e të hyrave vetanake dhe duke e ngritur shkallën e inkasimit sidomos në të hyrat nga tatimi në pronë. Këtë proces do ta ndihmonte rishikimi i fushës së financave të pushtetit lokal, përmes zgjerimit të burimeve të financimit.

- **Objektivi specifik 1.2.** Krijimi i mekanizmit të veçante për koordinimi e procesit të financimit të investimeve nga niveli qendror në nivelin lokal.

Krijimi i një sistemi efikas për menaxhimin e të dhënave për investimet e planifikuara. Rritja e nivelit të burimeve të financimit nga të hyrat vetanake do të ndikoj dukshëm në rritjen e investimeve kapitale e me të edhe mirëmbajtjen e këtyre investimeve e cila kërkon një trajtim të veçantë dhe të vazhdueshëm, si dhe shtimi i burimeve të reja nga të hyrat e TVSH një % e caktuar siç është praktik në vendet e rajonit të kaloj në komuna prej nga buron aktivitetit i biznesit gjithashtu të hyrat nga shfrytëzimi i pasurive natyrore të ndahet në proporcion të barabartë me nivelin qendror, pra të kthehen në investime në territorin në të cilin shfrytëzohen pasurit natyrore.

- **Objektivi specifik 1.3** Jetësimi i huamarrjes komunale përmes rritjes së performancës buxhetore komunale.

Rritja e performancës buxhetore komunale përmes zbatimit të rekomandimeve të auditorit do të ndihmon komunat që të arrijnë plotësimin e kriterëve të përcaktuara

në Ligjin për borxhe publike të cilit do të duhet të rishikohen dhe të jenë më të matshme dhe më të arritshme për komunat.

## **Objektivi strategjik nr.2: Tërheqja e investimeve të huaja.**

Tërheqja e investimeve të huaja ka për qëllim, hapjen e vendeve të reja të punës dhe ndikimin e madh në rritjen e të hyrave buxhetore dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të komunës, përqendrimin e bizneseve në një vend të caktuar dhe promovimin e tyre, zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve, krijimin e kushteve për biznese që të kenë qasje më të lehtë, rritjen e konkurrencës në biznesin vendor dhe ndërkombëtar, përsheptimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut.

- **Objektivi specifik 2.1** Krijimi i kushteve më të favorshme për investitorët e huaj.

Krijimi i mjedisit tërheqës për investime të huaja është ndër prioritet kryesorë. Komunat duhet të krijojnë ambient të përshtatshëm dhe siguri për investitorët e huaj përmes rregullimit të infrastrukturës rrugore, sigurimit të pronës publike, lehtësira të taksa komunale, lehtësim të procedurave administrative.

- **Objektivi specifik 2.2** Funkcionalizim i plotë i zonave ekonomike të balancuara.

Zonat ekonomike janë një komponentë e programit të hapësirave të punës dhe si koncept nënkupton ndërtimin e një infrastrukturë fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneset. Zhvillimi i zonave ekonomike përbën një faktor të rëndësishëm për përmirësimin e ambientit afarist dhe ndër të tjera ka për qëllim: krijimin e një ambientit fizik për bizneset vendore dhe ndërkombëtarë; tërheqjen e investimeve të reja (vendor dhe të huaja); grumbullimin e bizneseve në vende të përshtatshme për të bërë biznes; zgjerimi i industrisë ekzistuese; zhvillimin e lokaliteteve të caktuara. Zhvillimi i zonave ekonomike është një ndër elementet kryesorë të zhvillimit të sektorit privat, andaj edhe është me prioritet dhe ka lidhshmëri me dokumentet dhe planet strategjike të qeverisë të cilët kanë për qëllim zhvillimin ekonomik, duke krijuar dhe ofruar hapësirë të punës për biznese, objekte të

përshtatshme fizike në një ambient të kontrolluar dhe menaxhuar mire në një lokacion të përshtatshëm, të cilat janë një ndër elementet me të rëndësishme për zhvillim të sektorit privat.

- **Objekti specifik 2.3** Rritja e transparencës komunale në funksion të krijimit të kushteve për investime të huaja.

Planifikim i pronës së paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim me qëllim të rritjes së vlerës dhe tërheqjen e investitorëve të huaja ndikon në zhvillim ekonomik lokal. Inventarizimi i pronës së paluajtshme komunale si dhe promovimi i politikave për pronat që jepen në shfrytëzim për interes publik reflekton transparencë dhe llogaridhënie.

- **Objektivi strategjik nr.3: Fuqizimi i ekonomisë lokale përmes investimit në kapitalin njerëzor**

Ekonomia e një vendi bazohet në masë të madhe në kapitalin njerëzor të saj. Investimet në kapitalin njerëzor do të japin rezultatet e tyre në faza të mëvonshme, por kthimi në investime është i sigurt. Një fuqi punëtore më e aftë do të sigurojë jo vetëm normë më të lartë të rritjes ekonomike, por edhe rritje gjithëpërfshirëse. Kjo është kështu sepse rritja e përfshirjes së fëmijëve në programe arsimore, përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe ndërlidhja më e mirë mes shkollave dhe tregut të punës do t'u mundësojë fëmijëve nga familjet e varfra të fitojnë aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës.

Kosova sot qëndron më keq se rajoni sa i përket aftësive të fuqisë punëtore. Në një kohë kur papunësia në vend është shumë e lartë, paradoksi është se shumë ndërmarrje kanë problem të gjejnë punëtorë të shkathët. Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar i dekurajon investimet dhe është pengesë për ndërmarrjet tona që të rrisin produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre.

- **Objektivi specifik 3.1** Zhvillimi i aftësisë profesionale përmes avancimit të shkollave profesionale.

Zhvillimi i partneritetit mes shkollave të arsimit dhe aftësisë profesionale (AAP) dhe bizneseve, nga i cili do të përfitojnë dhe të kenë përkrahje të dyja palët, me qëllim të

zgjërimit të njohurive dhe të shkathtësive të nxënësve të AAP brenda një mjedisi praktik, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për punësim produktiv dhe nxënie të mëtejshme. Sistemi për Arsim dhe Aftësim Profesional në Kosovë synon të ketë një praktikë profesionale me cilësi të lartë të bazuar në kompetenca që mbështet rritjen e biznesit dhe jep për të gjithë nxënësit njohurinë dhe shkathtësitë për të cilat ata kanë nevojë në një mjedis të sigurve dhe të shëndetshëm pune.<sup>20</sup>

- **Objektivi specifik 3.2** - Ngritja e njohurive dhe shkathtësive të mësimdhënësve të shkollave profesionale dhe pajisja me materiale mbështetëse për të krijuar partneritete të suksesshme me ndërmarrjet.

Edhe pse mësimdhënësit kanë të njohura konceptet e bashkëpunimit me ndërmarrjet, ende ekziston nevoja e madhe për t'iu ofruar atyre një perspektivë të mirëinformuar mbi praktikën dhe proceset moderne të punës. Shkathtësitë teknike janë një element me rëndësi për arsimin profesional, ato duhet të ofrohen brenda një kornize që thekson se të gjitha shkathtësitë duhet të jenë të adaptueshme, në mënyrë që të rrisin shanset për punësim. Shkollat e arsimit profesional duhet të inkurajohen të kërkojnë të bashkëpunojnë me ndërmarrjet që të pasqyrojnë spektrin e plotë të aktivitetit ekonomik lokal sa më shumë që të jetë e mundur. Stafit mësimdhënës duhet të përkrahët nga të kuptuarit e një spektri më të gjerë të shkathtësive të ndërlidhura me punësimin.<sup>21</sup>

**Objektivi strategjik nr.4:** Shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Politikat e shteteve në zhvillim shpeshherë kufizohen vetëm në rëndësinë e ekzistimit të infrastrukturës apo burimeve natyrore. Por, për t'i shfrytëzuar burimet natyrore dhe infrastrukturën e një vendi, nevojitet një fuqi punëtore e aftë e cila di të prodhojë gjëra me vlerë.

- **Objektivi specifik 4.1:** Përmirësimi i kushteve të zhvillimit të Turizmit Lokal përmes investimeve dhe ngritjes së kapaciteteve.

---

<sup>20</sup> Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale 2013-2020

<sup>21</sup> Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale 2013-2020

Identifikimi i zonave të reja turistike, funksionalizimi i hapësirave me rëndësi të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe promovimit i tyre është një mundësi për komunat të tregojnë për potencialet e tyre. Trashëgimia kulturore dhe historike janë potencial për zhvillimin ekonomik. Promovimi i këtyre vlerave paraqet trendin zhvillimor të sektorit të turizmit. Zhvillimi dhe promovimi i turizmit përmes krijimit të pakove turistike të zhvilluara në bashkëpunim me operatorë turistik, si dhe krijimi i kushteve për promovim të turizmit lokal përmes panairëve, ku mund të çasen investitorët që të zhvillojnë aktivitetet e tyre në komunë. Në mbështetje të kësaj komponentë parashihet edhe organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve tjera për ngritje të kapaciteteve dhe rritje të cilësisë në shërbime.

- **Objektivi specifik 4.2:** Krijimi i bazës ligjore për subvencionimin e kamatës së kredive për prodhuesit vendor.

Duke pasur parasysh vështirësitë e prodhuesve vendor si: normat e larta të kamatave, burokraci bankare, vështirësi në plasimin e produkteve në tregjet rajonale etj, prodhuesit vendor kanë nevojë për mbështetje. Zhvillimi i politikave për subvencionimin e kamatës për prodhuesit vendor ndihmon në përkrahjen e prodhuesve vendor e cila do të reflektoj edhe në zhvillim ekonomik lokal.

- **Objektivi specifik 4.3:** Përmirësimi i infrastrukturës në funksion të bizneseve

Komunat janë përgjegjëse për organizimin dhe vënien në funksion të infrastrukturës lokale përfshirë rrugët, kanalizimin dhe ujësjellësit për të gjithë e në veçanti për bizneset të cilat ndikojnë në zhvillim ekonomik lokal.

### **7.3 Praktikë e vendeve të rajonit**

**Shqipëria** - Në Republikën e Shqipërisë Bashkia ka në funksionet e veta hartimin dhe zbatimin e programeve për zhvillim ekonomik vendor. Megjithatë, zhvillimi vendor nuk mbetet përgjegjësi e një aktori të vetëm, por kërkon një ndërveprim dhe partneritet të detyrueshëm midis aktorëve të ndryshëm në territor, duke përfshirë qeverisjen vendore, institucionet e dekoncentruara, komunitetin sipërmarrës dhe shoqërinë civile.

Çdo njësi vendore do të hartojë Planin Strategjik të Zhvillimit, i cili do jetë instrumenti kryesor planifikues për zhvillimin ekonomik vendor. Plani Strategjik i Zhvillimit do të jetë i harmonizuar me planet kombëtare dhe rajonale të zhvillimit dhe do të jetë baza e planifikimit të investimeve publike nëpërmjet Planit të Investimeve Kapitale (PIK) dhe do të shërbejnë për orientimin e investimeve të buxhetit të shtetit për njësitë e qeverisjes vendore.

Komuna dhe bashkia financohen nga këto burime kombëtare: a) Taksat dhe tatimet e ndara, në të cilat përfshihen një pjesë e tatimit mbi të ardhurat vetjake, si dhe një pjesë e tatimit mbi fitimin e subjekteve ekonomike. Të ardhurat vjetore nga këto taksa e tatime u jepen komunave dhe bashkive në jo më pak se tri 13 transferta në vit. Pjesa e taksës dhe tatimit që shkon në favor të tyre, si dhe mbledhja e administrimi përcaktohen me ligj për çdo taksë ose tatim të ndarë. b) Transfertat e pakushtëzuara nga Buxheti i Shtetit, që jepen sipas kriterëve të përcaktuara me ligj, bazuar në funksionet dhe kompetencat e veta ose të përbashkëta të komunave dhe bashkive, si dhe për arritjen e barazisë së burimeve mes njërive të ndryshme të qeverisjes vendore në raport me mundësitë e tyre për të krijuar të ardhurat e nevojshme. c) Transfertat e kushtëzuara nga Buxheti i Shteti.

**Maqedonia** - Planifikimi strategjik është metodë demokratike në komunë për krijimin e vizionit dhe të strategjive që të arrihet e ardhmja e dëshiruar për komunën, për orientimin e aktiviteteve dhe projekteve për implementim të këtyre strategjive dhe për prezantimin e tyre në formë të dokumentit – Plan strategjik. Përvoja ndërkombëtare flet për planifikim strategjik i cili është afatgjatë dhe për planifikim operativ i cili është më afatshkurtër.

“Shfrytëzuesit e Buxhetit përgatisin plan strategjik trevjeçar i cili përfshin programe dhe aktivitete për plotësimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe qëllimeve dhe prioriteteve të shfrytëzuesve të Buxhetit për periudhën relevante”. Në bazë të ligjit, komuna është shfrytëzues i Buxhetit. “Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet t’i përcaktojë prioritetet strategjike për vitin e ardhshëm më së voni deri më 15 prill të vitit në vijim. Prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë si grup i qëllimeve dhe iniciativave janë

detyrimisht të përfshira në buxhetin e shfrytëzuesve të Buxhetit të shfrytëzuesve të mjeteve përmes programeve dhe nën programeve qeveritare". Në bazë të rolit demokratik dhe autonom si qeveri lokale, komunat mund të definojnë qëllimet e tyre lokale dhe prioritetet për planifikimin e tyre strategjik, por ato duhet të jenë të barazuara me prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e buxhetit shtetëror.

Ministria për vetëqeverisjes lokale e koordinon planifikimin e zhvillimit të qeverive lokale në mënyrë të pavarur edhe në rajonet. Ligji për planifikim hapësinor dhe urban i vitit 2005 jep kornizë për planifikim hapësinor dhe për lloje të ndryshme të planifikimit urban komunal. Planifikimi hapësinor duhet t'a mbulojë territorin e Republikës, por mund të bëhet edhe plan specifik hapësinor për një rajon ose për një vend me interes të posaçëm për Republikën. Planet urbane janë të katër llojeve: Planet e përgjithshme urbane Plane detale urbane Plane urbane për vende të banuara

Komunat kanë liri për zhvillimin e sistemit të tyre, gjë që është e mirë meqë ato dallohen njëra me tjetrën, bazat e tyre nismëtare dhe nevojat për planifikim dallohen, si dhe kapacitetet e tyre për planifikim.

Planifikimi strategjik i zhvillimit lokal të komunave shërben për disa qëllime, duke përfshirë: 1. Definim të tërësishëm të vizionit afatgjatë të komunës; 2. Definim i rajoneve strategjike të fokusuar, qëllimet reale strategjike dhe konkrete, konsekuente me vizionin dhe qasja e resurseve në afat kohor të caktuar; 3. Komunikim i qëllimeve deri tek pjesëmarrësit komunal; 4. Zhvillimi i ndjenjës së pronësisë ndaj planit strategjik për zhvillim lokal të komunës; 5. Përdorimi më efikas i resurseve në qasje, me fokusim tek prioritetet kyçe; 6. Krijimi i sistemit të vlerësimit, mbikëqyrje dhe kontroll i realizimit të aktiviteteve të planifikuara;

Procesi i suksesshëm i planifikimit strategjik të komunës bazohet në disa parakushte:- Pjesëmarrja e personave të vërtetë në procesin e planifikimit strategjik. Kjo përfshin përgjegjësi kompetente udhëheqëse dhe teknike për procesin, resurset participative hyrëse nga secila palë e tanguar e cila do të jetë përgjegjëse për kryerjen e disa pjesëve të planit, përfaqësues të grupeve ndaj të cilave do të ketë ndikim realizimi i planit, si

dhe përfaqësuesit e zgjedhur të cilët janë përgjegjës që ta kontrollojnë dhe miratojnë planin; - Regjistrimi i informacioneve (të dhënave hyrëse) për planifikim dhe komunikimin e tyre të zgjeruar, që t'u jepet pjesëmarrësve kryesor mundësi për të reaguar nëse ka nevojë; - Vendosje racionale e qëllimeve afatgjate dhe afatshkurtra sipas informacioneve në qasje, resurseve dhe kohës reale për planifikim; - Specifikim i qartë i përgjegjësive dhe kufijve kohor për arritjen e secilit rezultat; - Në mesin e planifikimit i cili shpejtë ndryshon dhe ku parashikimi i resurseve është e lidhur me vështirësi, normalisht është që të ndodhin lëshime nga plani. Plani strategjik është vetëm kornizë e përgjithshme për kahje të identifikuar të zhvillimit. Lëshimet nga plani duhet të vendosen si ndryshime, ku më së miri është nëse bëhet ashtu gjatë azhurnimit të planit aksional. - Vlerësimi i planit strategjik për zhvillim lokal të komunës, duhet të zbatohet në disa intervale kohore të caktuara, edhe atë përmes disa kontrolleve të rregullta të implementimit të tij, përmes vlerësimit të plotësimit të qëllimeve konkrete dhe strategjike, respektivisht përmes identifikimit të arsyeve për problemet potenciale për realizimin e tij.

**Serbia** - Në Serbi ka gjithnjë e më shumë qytete dhe komuna që përfaqësojnë vende të cilësisë për jetesë, biznes dhe investime. Në këto qeveri lokale, pavarësisht nga kriza ekonomike, janë gjetur burime alternative të fondeve për investime të mëtejshme në infrastrukturë, papunësia është më e ulët se mesatarja kombëtare, në reputacionin e atyre që kanë bërë progres në këtë proces, janë bërë liderë në tërheqjen e investimeve dhe duke përdorur fonde nga IPA ata fillojnë të planifikojnë dhe zhvillojnë prioritetet strategjike të zhvillimit dhe të përgatisin strategjitë e zhvillimit. Arsyeja e parë rrjedh nga fakti që të gjitha projektet në çdo fushë të zhvillimit lokal kërkojnë aktivitete të planifikuara të sinkronizuara dhe të koordinuara në nivelet e ndryshme të komunës, domethënë të qytetit, si dhe në nivelet ekzekutive dhe administrative të vendimmarrjes në Republikë.

Sipas disa analizave të kryera së fundmi në Republikën e Serbisë, aktualisht ekzistojnë tri grupe komunash: a) ata që kanë një plan gjithëpërfshirës të zhvillimit të komunitetit lokal (nganjëherë quhet një plan i zhvillimit të qëndrueshëm); b) ato që kanë vetëm plane sektoriale (në zonat që komuna vlerësohet të jetë më e rëndësishmja



ose për të cilën kanë siguruar financim të jashtëm); c) Komunat pa plane sektoriale. Për disa vite, në Serbi, mbështetja u është dhënë vetëqeverisjeve lokale (në kuadër të projekteve pilot) me qëllim organizimin, përgatitjen dhe monitorimin e zbatimit të strategjive sektoriale të zhvillimit, si dhe trajnimin për forcimin e kapaciteteve institucionale lokale për monitorim adekuat të zbatimit të strategjive zhvillimore lokale. Ministria kryesore për çështjet e zhvillimit lokal është Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit Rajonal. Kjo ministri përfaqëson një nga sistemet më komplekse brenda administratës shtetërore në Serbi. Brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit Rajonal, ka gjithashtu një numër agjencish me një rol të rëndësishëm në lidhje me zhvillimin ekonomik lokal. Në mesin e agjencive të rëndësishme për zhvillimin lokal, duhet të përmendet Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP), i cili është i njohur nga shumë programe trajnimi për të papunët. Zyra për Planin Kombëtar të Investimeve të Qeverisë së Republikës së Serbisë është elementi më i rëndësishëm në sistemin e financimit nga niveli republikë të projekteve të mëdha investuese në nivel lokal (infrastruktura komunale dhe sociale). Njësitë e menaxhimit për trajtimin e çështjeve ekonomike janë më së shpeshti të vendosura si zyra për zhvillim lokal (ekonomik). Në një numër më të vogël komunash, këto zyra janë të themeluara në Kabinetin e Kryetarit të Komunave. Arsyeja për një organizatë të tillë është përpjekja për të mbajtur organet e selisë në kontakt të ngushtë me njeriun e parë në komunë. Zyrat e zhvillimit lokal brenda administratës komunale janë më së shpeshti të themeluara si departamente (njësi themelore organizative brenda administratës) ose edhe më shpesh si departamente (njësi organizative brenda një departamenti - zakonisht për financa dhe ekonomi). Ekziston gjithashtu një larmi e madhe e aktiviteteve të kryera nga zyrat e zhvillimit ekonomik lokal. Me një fjalë, mund të thuhet se ka dy ekstreme. Në një nga zyrat që veprojnë pothuajse ekskluzivisht si njësi për shkrimin e projekteve zhvillimore dhe nga ana tjetër, të cilat kanë kompetenca më të gjera, nga hartimi i një propozimi të planit strategjik, nëpërmjet përfshirjes në përgatitjen e buxhetit dhe planeve hapësinore komunale, në zbatimin e strategjive zhvillimore.

## 8. INTERVENIMET KRYESORE TË STRATEGJISË

Kjo strategji do të përcaktoj politikat për hartimin e strategjive lokale për zhvillim ekonomik, ku kjo strategji për zhvillim ekonomik lokal do të trajtoj çështjet të cilat do të trasonin rrugën për mundësi më të mëdha dhe për krijim të një ambienti më të përshtatshëm dhe shërbime më të kënaqshme për qytetarët si;

- Qëndrueshmëria financiare e komunave do të ndikojnë në ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe komunitetin e biznesit duke rritur pavarësinë financiare nga niveli qendror.
- Tërheqja e investimeve të huaja me qëllim të hapjes së vendeve të reja të punës dhe ndikimin e madh në rritjen e të hyrave buxhetore dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të komunës ndihmon në zhvillim të qëndrueshëm komunal.
- Ekonomia e një vendi bazohet në masë të madhe në kapitalin njerëzor të saj. Investimet në kapitalin njerëzor do të japin rezultatet e tyre në fazë të mëvonshme, por kthimi në investime është i sigurt.
- Për shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe infrastrukturës lokale, nevojitet një fuqi punëtore e aftë e cila di të prodhojë gjëra me vlerë.

## 9. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

### 9.1 Monitorimi dhe raportimi i Strategjisë

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal 2019-2023 ka edhe planin e vet të veprimit që mbulon periudhën 2019-2021 i cili përbëhet nga aktivitetet, indikatorët, institucionet përgjegjëse.

Plani i veprimit të Strategjisë do të rishikohet në baza vjetore në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në Strategji.

Struktura për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal përbëhet nga indikatorët matës, të cilët janë të vendosur në nivel të objektivave specifike në strategji për vitin 2019 dhe 2023.

Pas aprovimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal nga qeveria, do të përgatitet një model strategji për tu ndihmuar komunat në hartimin e strategjive të tyre.

## **10.NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË**

### **10.1 Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve**

Plani i Veprimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal në Kosovë 2019-2021 ka një kosto totale të zbatimit prej 16,783,271.00 Euro.

### **10.2 Burimet e financimit të Strategjisë**

Financimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2019-2021 parashihet të bëhet nga buxhetet ekzistuese të komunave dhe Ministrive të Linjës.

## 11.SHTOJCA 1: Plani për Zbatimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

Plani i Veprimit për Zbatimin e SZHEL						
Objektivi strategjik #1: Qëndrueshmëria financiare e komunave.						
Objektivi specifik 1.1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2021	Caku 2023
Zvogëlimi i varësisë buxhetore të komunave nga niveli qendror përmes rishikimit të formulës së financimit.	1. Përqindja e zvogëlimit të varësi buxhetore të komunave nga niveli qendror 2.Ndryshimi i formulës së financimit			85%	80%	70%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. Udhëheqës	Inst. Mbështetës	Produkti
Hartimi i Koncept dokumenti për politikën e financimit të komunave	K1-K4, 2019	8,160.00	BRK	MF	MAPL, MASHT, MSH, MPMS, AKK, Komunitat	Koncept dokumenti i aprovuar
Plotësimi/ndryshimi i LFPL	K1-K4, 2019	8,160.00	BRK	MF	MAPL, MASHT, MSH, MPMS, AKK, Komunitat	LFPL i aprovuar
Organizimi i fushatave vetëdijuese për rritjen e shkalles se inkasimit te te hyrave	2019-2020	10,900.00	BRK	MF, MAPL	Komunitat, Shoqëria civile	Fushata e realizuar
Analiza lidhur me shqyrtimin e mundësive për inkasimin e te hyrave nga shfrytëzimi i pasurive natyrore brenda territorit të komunës	K1-K4, 2020	10,000.00	BRK	MMPH, MF, MAPL,	Komisioni për Miniera dhe Minerale dhe Komunitat	Analiza e hartuar,
Analiza lidhur me	K1-K4, 2020	10,000.00	BRK	MF, MAPL	Komunitat, Shoqëria civile	Analiza e përfunduar

shqyrtimin e mundësive të ndarjes së një përqindje të TVSH për komuna						
Marrja e përvojave të vendeve të rajonit lidhur mundësitë e ndarjes së një përqindje të TVSH për komuna	K1-K4, 2020	11,000.00	BRK	MF, MAPL	Komunat, Shoqëria civile	Ngritja e kapaciteteve
<b>Objektivi specifik 1.2</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Krijimi i mekanizmit të veçantë për koordinimin e procesit të financimit të investimeve nga niveli qendror në nivelin lokal.	1.Përqindja e balancimit të investime kapitale në komuna, 2.Rritja e mirëmbajtjen e investimeve në komuna			2%	10%	30%
				1%	3%	10%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Krijimi i sistemit (platformës)për balancimin investimeve nga niveli qendror, në nivelin lokal	2019-2020	12,000.00	BRK	MF, MAPL	Ministritë e Linjës	Platforma e funksionalizuar
Krijimi i komisioni ndërministror për balancimin investimeve	K1-K4, 2019	2,000.00	BRK	MF, MAPL	Ministritë e Linjës	Komisionin i themeluar
Planifikimi i mirëmbajtje të investimeve kapitale nga komuna	2019-2020	10,000.00	BRK	MF, MAPL	Ministritë e Linjës	Ndarja e mjeteve për mirëmbajtje të investimeve kapitale nga komuna
<b>Objektivi specifik 1.3</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>

Huamarrja komunale përmes rritjes së performancës buxhetore komunale.	1.Krijimi kushteve ligjore për lehtësim të huamarrjes 2.Rritja e performancës buxhetore komunale përmes zbatimit të rekomandimeve të auditorit			20%	40%	60%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Analiza lidhur me shqyrtimin e mundësive për lehtësimin e kriterëve për huamarrje komunale	K4, 2019	4,000.00	BRK	MF	MAPL, ZKA	Analiza e publikuar,
Hartimi i politikave efektive për lehtësimin e kriterëve për huamarrje komunale	K4, 2020	4,000.00	BRK	MF	MAPL, ZKA	Koncept dokumenti për trajtimin e legjislacionit të borxhit publik, i hartuar
Promovimi me i mirë i menaxhimit të parasë publike	2019-2020	8,000.00	BRK	MF, MAPL	ZKA, Komunitat	Realizimi i një takimi vjetor
Ndarja e granteve për komuna sipas performancës	2019-2020	4,050,851.00	BRK	MAPL	MF, Donatore,	Granti i ndarë sipas performancës në komuna
<b>Objektivi strategjik #2: Tërheqja e investimeve të huaja</b>						
<b>Objektivi specifik 2.1</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Krijimi i kushteve më të favorshme për investitorët e huaj.	1.Ulja së taksave komunale 2. Rritja e investimeve përmes dhënies së pronës komunale në shfrytëzim			0%	10%	20%

Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Inventarizimi i pronës së paluajtshme komunale	K1-K4, 2019	6,000.00	BRK	Komunat	MAPL, AKK,	Regjistri i azhurnuar i pronës së paluajtshme komunale
Planifikim i pronës së paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim	K1-K4, 2019	5,000.00	BRK	Komunat	MAPL, AKK,	Lista vjetore e pronave të destinuar për shfrytëzim, e publikuar
Promovimi i politikave për pronat që jepen në shfrytëzim për zhvillim ekonomik lokal	K1-K4, 2020	8,500.00	BRK	MAPL, Komunat	Ministritë e Linjës,	Model -Informator për pronat komunale
Ndryshimi i rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale	K1-K4, 2019	5,000.00	BRK	MF, Komuna	MAPL	Rregullorja e hartuar,
<b>Objektivi specifik 2.2</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Funksionalizimi i plotë i zonave ekonomike të balancuara	Rritja e numrit të bizneseve			10%	20%	30%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Identifikimi i zonave potenciale ekonomike	K1-K4, 2019	1,500,000.00	BRK	MTI, Komunat	MAPL, OEK	Raporti identifikues
Zhvillimi i zonave ekonomike duke mbështetur	2019-2020	1,784,000.00	BRK	MTI, Komunat	MAPL, OEK	Informator të publikuar për sektorin privat

zhvillimi e sektorit privat						
<b>Objektivi specifik 2.3</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Rritja e transparencës komunale në funksion të krijimit të kushteve për investime të huaja.	Rritja e numrit të publikimeve për pronat komunale			10%	20%	30%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Azhurnimi i web faqeve komunale	K1, 2019	32,000.00	BRK	Komunat	MAPL	Web-faqet e azhurnuara
Publikimi i informative lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim	K1-K4, 2019	25,000.00	BRK	Komunat	MAPL	Publikimet e shpallura
Negocimi i ofertave nga Kryetari i komunës me të gjithë personat fizik dhe juridik që shprehin interes për marrje të pronës në shfrytëzim	2019 -2020	62,700.00	BRK	Komunat	MAPL	Marrëveshjet e arritura
<b>Objektivi strategjik #3: Fuqizimi i ekonomisë lokale përmes investimit ne kapitalin njerëzor</b>						
<b>Objektivi specifik 3.1</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Zhvillimi i aftësimin profesional përmes avancimit të shkollave profesionale.	Rritja e kuadrove profesionale për tregun e punës			10%	15%	30%



Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Ngritja e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve	2019-2020	27,000.00	BRK	MASHT	Komunat, Donatorët	Trajnimet e mbajtura për mësimdhënës
Zgjerimi i profileve të reja në kuadër të shkollave profesionale	2019-2020	22,500.00	BRK	MASHT	Komunat	Profilet e reja të hapura
Analiza lidhur me shqyrtimin e mundësive për krijimin e hapësirave të reja për aftësim profesional.	K1-K4, 2019	8,000.00	BRK	MASHT	Komunat	Analiza e hartuar
Promovimi i shkollave profesionale	2019-2020	16,500.00	BRK	MASHT	Komunat	Panairi vjetor i organizuar
<b>Objektivi specifik 3.2</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Ngritja e njohurive dhe shkathtësive të mësimdhënësve të shkollave profesionale dhe pajisja me materiale mbështetëse për të krijuar partneritete të suksesshme me ndërmarrjet	Rritja e numrit të trajnimeve të mësimdhënësve			15%	20%	40%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Identifikimi i shkathtësive që përdoren nga bizneset moderne	K1-K4, 2019	51,500.00		MASHT, Komunat	Komuniteti i bizneseve, MAPL	Raporti identifikues i shkathtësive

Organizimi i trajnimit për zhvillimin e shkathësive personale për menaxhim të karrierës	K1-K4, 2020	12,000.00		MASHT, Komunat	Komuniteti i bizneseve, MAPL	Trajnimi i realizuara
Objektivi strategjik #4: Shfrytëzimi i resurseve ne funksion te zhvillimit te qëndrueshëm ekonomik.						
<b>Objektivi specifik 4.1</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Përmirësimi i kushteve të zhvillimit të Turizmit Lokal përmes investimeve dhe ngritjes së kapaciteteve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përqindja e zonave te kompletuara me infrastrukturë</li> <li>• Numri i objekteve të menaxhuara dhe të mirëmbajtur nga komunat</li> <li>• Përqindja e inkasimit të hyrave nga objektet e trashëgimisë</li> </ul>			10%	15%	20%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Identifikimi i zonave të reja për zhvillim të turizmit	2019-2020	25,000.00	BRK	Komuna, MTI	MMPH, MKRS, MAPL	Zonat e identifikuar
Përmirësimi i infrastrukturës lokale ne zonat turistike	2019-2020	2,016,000.00	BRK	Komunat, MTI	MAPL, MKRS, MASHT, MMPH, MI, MAPL	Infrastruktura e kompletuar
Organizimi i panairove për promovimin e turizmit	2019-2020	50,000.00	BRK	Komunat, MTI	MKRS, Donatore, Këshilli për Trashëgimi Kulturore, MAPL	Panairot e ndryshme të organizuara në komuna
Evidentimi i hapësirave me rendësi te trashëgimisë kulturore dhe funksionalizimi i tyre për vizita turistike	K1-K4,2019	14,500.00	BRK	Komunat, MTI	MKRS, Këshilli për Trashëgimi Kulturore, MAPL	Vendosja e tarifave hyrëse për vizita ne objektet e trashëgimisë kulturore
Krijimi i pikave informuese për promovimin e turizmit lokal	2019- 2020	1,724,000.00		Komunat, MTI	MKRS, MAPL	QENDRAT E THEMELUARA PER TURIZEM në komuna

Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komuna	2019-2020	100,000.00	BRK	MKRS, MTI	Komunat, MAPL	Profilet për trashëgiminë kulturore dhe natyrore në komuna të hartuara
<b>Objektivi specifik 4.2</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Krijimi i bazës ligjore për subvencionimin e kamatës së kredive për prodhuesit vendor.	Rritja e bizneseve prodhuese në komuna			2%	5%	10%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Përgatitja e dokumentit rreth shqyrtimit të mundësive për mbështetje të prodhuesve vendor përmes subvencionimin e kamatës	2019- 2020	21,000.00	BRK	MF	Komunat, MAPL, AKK	Dokumenti i hartuar
Zhvillimi i politikave për subvencionimin e kamatës për prodhuesit vendor	2019-2020	158,000.00	BRK	MF	Komunat, MAPL, AKK	Koncept-dokumenti i hartuar
<b>Objektivi specifik 4.3</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>			<b>Baza</b>	<b>Caku 2021</b>	<b>Caku 2023</b>
Përmirësimi i infrastrukturës në funksion të bizneseve	Rritja e numrit të bizneseve të reja në komuna			5%	10%	20%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Zgjerimi i infrastrukturës lokale	2019-2020	4,024,000.00	BRK	Komunat	MAPL,MI,MF MMPH,	Infrastruktura lokale e kompletuar (rrugët, kanalizimi, ndriçimi, ujësjellësi)

Promovimi i bizneseve vendore	2019-2020	936.000.00	BRK	Komunat	MAPL,MI,MF MMPH,	Informatorët e përgatitur
----------------------------------	-----------	------------	-----	---------	------------------	------------------------------

2